Autoriteti i Çeritifikimit

Teza me Përgjigjet

Provimi i datës 18.05.2011

"E DREJTA CIVILE, PENALE, LEGJISLACIONI TREGTAR DHE E DREJTA E PUNËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

I. E DREJTA TREGTARE DHE E SHOQËRIVE TREGTARE (65 Pikë)

I.1 Përzgjidhni dhe shkruani në fletore përgjigjen e saktë (2 pikë secila)

1. Asambleja e Përgjithshme ka kompetenca:

a) vendimarrje;
b) monitorimi;
c) kompetenca që lidhen me organizimin e brendshëm të shoqërisë;
d) a) dhe b);

Përgjigja: (d)

2. Nëse kreditorët kanë paraqitur në gjykatë kërkesë për hetim të posaçëm:

a) mbajnë përgjegjësi nëse kërkesa është e pabazuar;
b) mbajnë përgjegjësi nëse kërkesa është paraqitur në keqbesim;
c) në asnjë rast nuk mbajnë përgjegjësi;
d) në çdo rast ligji u njeh të drejtën për të kërkuar hetim të posaçëm;

Përgjigja: (b)

3. Zmadhimi i autorizuar i kapitalit:

a) bëhet me vendim të asamblesë së përgjithshme;
b) bëhet me vendim të administratorëve;
c) nuk ka limit për zmadhimin e kapitalit;
d) asnjë alternativat më sipër;

Përgjigja: (b)

4. Nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ortaku mund të largohet:

a) në çdo kohë;
b) vetëm në ato raste dhe shkaqe të parashikuara nga ligji;
c) vetëm në rast se ka kryer veprime në dëm të shoqërisë;
d) vetëm nëse jepet miratimi i të gjithë ortakëve të tjerë;

Përgjigja: (b)

5. Në shoqërinë kolektive:

a) ortakët përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë me gjithë pasurinë e tyre;
b) ortakët përgjigjen vetëm për detyrimet e marra përsipër personalisht në emër të shoqërisë;
c) ortakët përgjigjen solidarisht vetëm me pasurinë e shoqërisë;
d) asnjë nga rastet e sipërpërmëndura;

Përgjigja: (a)

I.2 Shpjegoni dhe jepni përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

1. Cilat shoqëri mund të bashkohen dhe si realizohet bashkimi i tyre ? (5 pikë)

Përgjigja:
Sipas nenit 214 vetëm shoqëritë e kapitalit dhe përkatësisht shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionere. Janë të përjashtuara nga bashkimi shoqëritë e personit.

2. A mundet Sh.P.K-ja të hedh në treg aksione me të drejtë vote ? (4 pikë)

Përgjigja:
Jo, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë**,** Neni 68/3. Emetimi i aksioneve në treg ndodh vetëm tek shoqëritë aksionere.

3. Si vlerësohen kontributet në natyrë tek shoqëria aksionere ? (5 pikë)

Përgjigja:
Kur aksionarët japin kontribute në natyrë, këto kontribute duhet të vlerësohen përpara regjistrimit të shoqërisë nga një apo disa ekspertë të caktuar nga gjykata përkatëse Neni 112.

Vlerësimi i kontributeve në natyrë nga ekspertë kontabël të caktuar nga gjykata bëhet vetëm tek shoqëritë aksionere, ndërsa tek shoqëritë e personit apo tek SH.P.K, ortakët i vlerësojnë kontribuetet në natyrë në marrëveshje të ndërsjelltë midis tyre dhe vetëm nëse nuk arrijnë një marrëveshje mund t'i drejtohen gjykatës përkatëse e cila ngarkon për vlerësimin e kontributeve në natyrë një ekspert kontabël.

4. Dividendi eshtë:_____ (5 pikë)

Përgjigja:
Dividendi eshtë: pjesa që i takon secilit aksioner nga vlera e fitimeve vjetore, e cila vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme. Fitimet vjetore llogariten sipas ligjit 'Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare'. Si rregull nëse nuk është parashikuar ndryshe ne statut dividendi u ndahet aksionerëve në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar që aksionet e secilit aksionar përfaqësojnë. E drejta e dividendit mund të ndryshohet vetëm me nje vendim të marrë me ¾ nga asambleja e pergjithshme, Neni 128.

5. Ku qëndron dallimi midis degëve dhe zyrave të përfaqësimit ? (5 pikë)

Përgjigja:
Degët dhe zyrat e përfaqësimit janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë kryesore. Degët veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë. Ndërsa zyrat e përfaqësimit, nuk kanë si qëllim krijimin e të ardhurave, por nxitjen e veprimtarisë së shoqërisë. Zyra mund të lidhë marrëveshje në emër e për llogari të saj.

6. Cila eshte pergjegjesia e ortakeve te pakufizuar ne nje shoqeri komandite ? (5 pikë)

Përgjigja:
Shoqëria komandite, përfshin dy kategori ortakësh: ortakë të kufizuar dhe ortakë të pakufizuar. Ndërsa ortakët e kufizuar, përgjigjen për detyrimet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit që kanë dhënë në shoqëri, ortakët e pakufizuar përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare, me të gjithë pasurinë e tyre për detyrimet e shoqërisë. Kjo do të thotë që ortaku i pakufizuar përgjigjet për detyrimet e shoqërisë, jo vetëm me kontributin që ka dhënë në shoqëri në momentin e themelimit të saj, por në rast se pasuria e shoqërisë nuk mjafton, përgjigjet me të gjithë pasuritë e tij. Çdo marrëveshje të kundërt me parashikimin më sipër, konsiderohet, sipas ligjit, e pavlefshme.

7. A mund të jenë personat juridikë administratorë në një Sh.p.k ? (8 pikë)

Përgjigja:
Administratori është një figurë e rëndësishme në drejtimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Sipas ligjit të ri, si administratorë në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të jenë vetëm personat fizikë të cilët emërohen e shkarkohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë. Kështu, ligji ka përjashtuar mundësinë e administrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nga një person juridik. Afati i emërimit nuk mund të jetë më i gjatë se 5 duke patur të drejtën e ripërtëritjes. Gjithsesi, kohëzgjatja e afatit të emërimit caktohen në statut.

8. Kur konsiderohet e çregjistruar shoqëria tregtare ? (8 pikë)

Përgjigja:
Një shoqëri tregtare çregjistrohet qoftë vullnetarisht apo në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Pasi në QKR është paraqitur vendimi i përfundimit të procedurës së likuidimit, subjekti çregjistrohet duke i vënë shënimin "i çregjistruar" , por të dhënat e subjekteve të çregjistruara ruhen në formatin elektronik nga QKR. Çregjistrimi i shoqërisë tregtare nga regjistri tregtar ka si pasojë humbjen e personalitetit juridik, ndërsa për subjektet e tjera që me anë të regjistrimi nuk fitojnë personalitet juridik, çregjistrimi ka vetëm efekt deklarativ.

9. Cilat janë funksionet e QKR-së ? (10 pikë)

Përgjigja:
Funksionet e QKR përcaktohen në ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Ndër funksionet kryesore të QKR rendisim:

a) mbajtja e regjistrit tregtar;
b) kryerja e regjistrimeve në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e ligjit;
c) kryerja e regjistrimit të subjekteve, të përcaktuara në ligj, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe inspektimit të marrëdhënieve të punës;
d) lëshimi i certifikatave, ekstrakteve të regjistrimeve dhe kopjeve të vërtetuara të akteve, të depozituara sipas përcaktimit të këtij ligji;
e) publikimi i të të dhënave të regjistrit të mbajtur, si dhe sigurimi i aksesit të lirë të publikut në to;
f) pranon kërkesat për licenca, leje dhe autorizime administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe ia dorëzon ato aplikantit pas miratimit nga organet përkatëse;
g) informon dhe këshillon për procedurat e regjistrimit dhe të licencimit.

II. E DREJTA E FALIMENTIMIT (10 Pikë)

Shpjegoni **(2 pikë secila)**

1. Cila është përbërja e komitetit të kreditorëve ?

Përgjigja:

Në përbërje të komitetit të kreditorëve duhet të ketë përfaqësues të:

- kreditorëve të siguruar;
- kreditorëve të falimentimit me pretendimet më të mëdha;
- kreditorëve të falimentimit të shumave më të vogla;
- punonjësve të debitorit, kur këta janë kreditorë falimentimi me pretendime të ndjeshme.

2. Si caktohet administratori i falimentimit dhe cilat janë cilësitë që duhet të ketë ai ?

Përgjigja:

Administratori i falimentimit emërohet me vendimin për hapjen e procedurës së falimentimit. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit cakton si administrator falimentimi një person fizik të licencuar si ekspert në fushën ekonomike ose juridike, i pavarur nga kreditorët dhe debitorët;

- i cili ka aftësi profesionale të përshtatshme dhe përvojë në biznes dhe është i licencuar si ekonomist, noter dhe jurist në përputhje me ligjet dhe rregullat shqiptare dhe ka përfunduar arsimin profesional dhe provimin përkatës;
- i caktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave si administrator falimentimi në mënyrë të përkohshme për periudhën derisa numri i mjaftueshëm i administratorëve të falimentimit të përfundojë arsimin profesional dhe provimin.

3. Përmendni disa prej funksioneve të Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentimit.

Përgjigja:

Agjencia e Mbikqyrjes së Falimentimit:

- jep, heq ose rinovon licencat për administratorët e falimentimit;
- organizon dhe zhvillon provimin për administratorët e falimentimit;
- mban regjistrin e administratorëve të licencuar të falimentimit;
- mbikqyr veprimtarinë e administratorëve të falimentimit dhe monitoron ecurinë e profesionit;
- mbikqyr zbatimin e dispozitave që rregullojnë procedurat e falimentimit;
- mbledh dhe përpunon të dhënat që lidhen me zbatimin e procedurave të falimentimit;
- propozon standarte për administrimin e masës së falimentimit si dhe Kodin e Etikës.

4. Çfarë ndodh në rastet kur nuk ka më pasuri në masën e falimentimit ?

Përgjigja:
Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ndërpret procedurën e falimentimit.

5. Çfarë është mbingarkesa me borxhe ?

Përgjigja:
Pasuritë e debitorit, person juridik, nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe, në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë.

III. E DREJTA E PUNËS DHE SIGURIMET SHOQËRORE (10 Pikë)

Shpjegoni (2.5 pikë secila)

1. Cilët janë subjektet e ligjit të sigurimeve shoqërore ?

Përgjigja:
Shtetasit shqiptar dhe te huaj te cilet kryejne veprimtari ekonomike ne territorin e Shqiperise. Shtetasit shqiptar ekonomikisht jo aktiv te cilet kane burime te ligjeshme.

2. A paguan sigurime shoqërore një pensionist i punësuar ?

Përgjigja:
PO. Sepse heq dore nga pensioni dhe krijon marredhenie pune.

3. A mund të kërkojë shtyrje të lejes vjetore një punëmarrës, i cili gjatë kohës së lejes është i sëmurë dhe ka përfituar raport mjëksor ?

Përgjigja:
PO. Periudha me raport zbritet nga leja.

4. Cilat janë ndalesat që mbahen nga paga e punës?

Përgjigja:
Kontributet per sigurime shoqerore dhe shendetesore.

IV. E DREJTA CIVILE (10 pikë)

Shpjegoni **(2,5 pikë secila)**

1. Cili është kriteri ndarës ndërmjet sendeve të luajtshme dhe atyre të paluatjshme? Jepni nga një shembull për secilin send.

Përgjigja:
Kriteri ndarës qëndron në faktin nëse këto sende janë të lidhura me tokën në mënyrë të qëndrueshme apo jo. Kështu pra, janë sende të paluajtshme toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesa, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën. (një shtëpi, një fabrikë, etj)
Të gjitha sendet e tjera, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme. (psh. një libër, një telefon, një dollap, etj).

2. Nga ndryshon trashëgimia ligjore nga ajo testamentare?

Përgjigja:
Trashëgimtarë ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit dhe motrat dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti, të cilët thirren në trashëgim sipas rradhës së caktuar nga Kodi Civil.
Ndërsa trashëgimia testamentare kryhet me anë të testamentit, i cili është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të së cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes. Testamenti nuk mund të bëhet prej dy ose më shumë personave në një akt.

3. Çfarë kuptoni me të drejtën e parablerjes së bashkëpronarit?

Përgjigja:
Bashkëpronari, para se t'ia shesë pjesën e vet në sendin e paluajtshëm një personi që nuk është bashkëpronar, detyrohet të njoftojë me shkrim bashkëpronarët e tjerë nëse dëshirojnë të blejnë pjesën me të njëjtat kushte që do t'ia shesë personit të tretë. Nëse këta nuk përgjigjen brenda tre muajve, se dëshirojnë të blejnë pjesën bashkëpronari është i lirë të shesë pjesën e tij në persona të tretë.

4. Cilat janë llojet e posedimit?

Përgjigja:
Posedimi i personit jo pronar mund të jetë i ligjshëm ose i paligjshëm.
Posedimi është i ligjshëm kur poseduesi e ka posedimin nga pronri, në bazë të një veprimi juridik, në bazë të ligjit ose të një akti administrativ.
Në të gjitha rastet e tjera posedimi është i paligjshëm.

V. E DREJTA PENALE (5 pikë)

Shpjegoni

1. Çfarë kuptoni me veprën penale të mashtrimit? Kjo vepër kryhet vetëm individualisht apo edhe në bashkëpunim?

Përgjigja:
Vepra penale e mashtrimit është vjedhja e pasurisë me anë të gënjeshtrës ose shpërdorimit të besimit, e cila dënohet me gjobë ose më burgim gjer në pesë vjet.

Kjo vepër mund të kryhet edhe në bashkëpunim, dhe në këto raste, kur kryhet në bashkëpunim në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, dënohet më burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe, kur ka pasoja të rënda, me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Tiranë, më 19 maj 2011